



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:209767

Datë: 29.05.2024

KPPP.nr.1585/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbarimore të kreditorit Tali Com Sh.P.K., me adresë në Viti, me NUI: 810173807, kundër debitorit NNT ABC Sh.P.K., me adresë në Podujevë, me NUI: 811911751, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Arbër Shala, me seli të zyrës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.169/23 të datës 04.09.2023, të nxjerrë nga Përmbaruesi Privat Argjent Xheladini me seli të zyrës në Viti, jashtë seancës me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit NNT ABC Sh.P.K., me adresë në Podujevë, i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.169/23 të datës 04.09.2023, të nxjerrë nga Përmbaruesi Privat Argjent Xheladini, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, me Urdhrit Përmbarimor P.nr.169/23 të datës 04.09.2023, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme–faturave dhe atë: faturës nr.6-220-001-23 të datës 26.06.2023 dhe faturës nr.8-220-004-23 të datës 04.08.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit, nga mjetet e tij financiare në llogaritë bankare, t'i bartë në xhirollogarinë e Përmbaruesit, shumën prej 5,000.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e kalimit të afatit për pagesë e deri në përmbarim definitiv, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbauesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se dokumenti përmbaues si i tillë nuk mund të jetë i përmbaueshëm, për faktin se kreditori nuk i ka dorëzuar asnjëherë faturën debitorit, dhe për më tepër, fatura me të cilën kreditori ka paraqitur propozimin për përmbauesim, asnjëherë nuk është pranuar/nënshkruar dhe vulosur nga debitori, ndërsa nënshkrimi i cili figuron tek hapësira “pranoi”, nuk dihet se i kujt është, prandaj me vetëm një nënshkrim nuk mund të vërtetohet fakti se kush i ka pranuar këto fatura. Më tej ka theksuar se faturat e dorëzuara në propozimin për përmbauesim janë kopje dhe nuk janë në origjinal apo në kopje të vërtetuara sipas ligjit, andaj të njëjtat nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, dhe si të tilla nuk janë të përshtatshme për përmbauesim. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet kundërshtimi i debitorit, ndërsa urdhri për përmbauesim të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori që të paguajë shpenzimet e prapësimit në shumën prej 104 Euro, sipas tarifës së OAK-së, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës të cilat krijohen deri në përfundim të kësaj procedure.

Kreditori, në përgjigje në prapësim i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, me arsyetimin se për inicimin e procedurës përmbauesim, kreditori ia ka dorëzuar tri kopje të propozimit Përmbauesit Privat. Më tej ka theksuar se sipas mesazheve të komunikimit në whatsapp dhe viber, shihet se debitori e ka pranuar borxhin por vetëm ia shtyn kreditorit afatin e pagesës për çdo ditë. Ka shtuar se debitori e ka nënshkruar faturën në vendin e punës, ndërsa për vullë është arsyetuar se e ka në zyre dhe nuk mundet t’ia vulosë. Sa i përket pretendimit se faturat janë kopje, kreditori ka theksuar se i ka dorëzuar Përmbauesit Privat faturat në origjinal, dhe të njëjtat gjenden në shkresat e lëndës. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, si dhe i ka shpenzimet në shumën prej 104 Euro, për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbauesimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumentit i besueshëm është i përshtatshëm për përmbauesim po qe*

se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentet e besueshme faturën nr.6-220-001-23 të datës 26.06.2023 dhe faturën nr.8-220-004-23 të datës 04.08.2023, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit monetar, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës edhe pse kreditori rezultoi fitues i këtij procesi, megjithatë ai nuk e ka bashkëngjitur në shkresat e lëndës autorizimin e përfaqësuesit, prandaj gjykata e pati juridikisht të pamundshme t’ia njoh shpenzimet procedurale.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1585/23, me datë 29.05.2024

G j y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.